



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 1/4, DATË 01 / 08 / 2023

PËR

MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “DAJTI EXPRESS RESORT”, ME SUBJEKT DAJTI EXPRESS SH.A. NUIS/NIPT J81921002G

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 21 dhe 23 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Subjekti aplikues propozon zhvillimin e një investimi, i cili synon në ri-jetëzimin e ish Kampit të Pionerëve në një hotel malor me 5 yje, që do të ofrojë shërbime mikse në fushën e turizmit, me kapacitet total prej 77 (shtatëdhjetë e shtatë) dhomash, restorante, bare, SPA etj. Për të ri-jetëzuar dhe zhvilluar zonën përreth objekteve në funksion dhe njëkohësisht për ta bërë sa më të shfrytëzueshme nga ana turistike hapësirën, investitori propozon edhe vendosjen e 12 viletave me struktura druri, ndërtimin e një stalle kuajsh, zhvillimin e një zone të gjelbër dhe funksioneve rekreative, si dhe një kamp për fëmijë.
- Projekti zë një sipërfaqe totale rreth 80,000 m², në fshatin Linzë, Bashkia Tiranë, në Zonën Kadastrale 2460, me numër pasurish 496/420, 496/421 dhe 496/422 të llojit “truall” në pronësi të subjektit “Dajti Express” sha.
- Vlera e investimit të projektit të investimit “Dajti Express Resort” i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) Euro.
- Projekti i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike, duke parashikuar të punësojë 84 (tetëdhjetë e katër) persona.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit “Dajti Express Resort”.
2. Projekti i investimit strategjik “Dajti Express Resort” do të zhvillohet nga subjekti “Dajti Express” sha NUIS/NIPT J81921002G.
3. Projekti i investimit strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.
4. Projekti i investimit strategjik do të zhvillohet në fshatin Linzë, Bashkia Tiranë, ZK 2460 në pasuritë me Nr. 496/420, 496/421 dhe 496/422, të llojit “truall”, në pronësi të subjektit “Dajti Express” sha.
5. Projekti është pajisur me Leje Zhvillimi me Vendim Nr. 15 datë 21.10.2021 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin “Hotel, vileta dhe ambiente shërbimesh ish - Kampi i Pionerëve Dajt” me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”.
6. Projekti është pajisur me Leje Ndërtimi me Vendim Nr. 86/5 datë 28.04.2023 me objekt “Hotel, vileta dhe ambiente shërbimesh ish - Kampi i Pionerëve Dajt”, sipas Vendimit Nr. 31, datë 27.07.2022, të Këshillit Kombëtar të Territorit.
7. Projekti i investimit strategjik parashikon ri-jetëzimin e ish Kampit të Pionerëve në një hotel malor me 5 yje, ndërtimin e 12 vileta druri, një stalle për kuaj, zhvillimin e një zone të gjelbër dhe funksioneve rekreative, si dhe një kamp për fëmijë.
8. Statusi “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” i jepet projektit të investimit “Dajti Express Resort”, për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
9. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21 dhe neni 23 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit të investimit strategjik janë si më poshtë:
 - a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
 - c) Miratohet masa e drejta për akses në infrastrukturë mbështetëse/ndihmëse në bazë të legjislacioneve sektoriale.
10. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen në planin e veprimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
11. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit strategjik “Dajti Express Resort” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi

bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

12. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e zbatimit nga ana e autoriteteve publike të masave të përfshira në Planin e Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
13. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “DAJTI EXPRESS RESORT”

1. *Përmbajtja e planit të veprimit*

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. *Zbatimi i planit të veprimit*

Plani i veprimit monitorohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. *Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Dajti Express Resort”*

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “*Dajti Express Resort*”, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “**Dajti Express Resort**” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. *Hapat procedurale*

Propozimi nga investitori:

Investitori “Dajti Express” sha NUIS/NIPT J81921002G, kur paraqiti projektin e investimit tek

AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e tij.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në fazë. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Zgjerim dhe riparim i rrugës ekzistuese dhe modifikim dhe kthim i rrugës pjesërisht në pedonale për këmbësorët.	Po me kusht	MTM MIE	Të respektohen të gjitha kërkesat ligjore ne fuqi. Respektimi i përcaktimeve bazuar në faktin që projekti zhvillohet në një zonë pjesë e Parkut Kombëtar të Dajtit. Rruga “Tiranë – Dajt” është e mbuluar me kontratën e mirëmbajtjes me performancë “Tiranë - Dajt - Qafë Mollë - Bizë, Qafë Priskë - Shkallë – Shëngjergj, Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk – Farkë.” – 2-vjeçare, e cila përfundon më 07.01.2024.			
Suport për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese në zonë përkatësisht rruga e Dajtit që lidh Parkun Kombëtar të Dajtit me qytetin e Tiranës.	Po me kusht	MTM MIE	Të respektohen të gjitha kërkesat ligjore ne fuqi. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) administron vetëm asetet e rrjetit rrugor kombëtar. Shoqëria, duhet të marrë autorizimet përkatëse pranë ARRSH mbi hyrje daljet në rrugët kombëtare, nëse ka dhe nëse do t'i nevojiten, në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe akteve të tjera ligjore.			

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE
KRYEMINISTËR
EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO